



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/41

Datë: 31.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës i ri-procedon Kuvendit të Republikës së Kosovës Draft-Amendamentin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Draft-Amendamentin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia ri procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/41

Datë: 31.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për Kryetar dhe anëtarë të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës këta kandidatë:
  - 1.1. Z. Safet Hoxha, Kryetar;
  - 1.2. Z. Sami Uka, anëtar dhe
  - 1.3. Z. Ergin Kala, anëtar.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë